



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

“Projekt”

L I G J

Nr. _____ Datë _____ 2020

**PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2019**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe nenit 158 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 63 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar)”*, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimi i Raportit Vjetor të Konsoliduar të Zbatimit të Buxhetit

Miratohet Raporti Vjetor i Konsoliduar i Zbatimit të Buxhetit për vitin 2019, sipas dokumentave të mëposhtëm, pjesë përbërëse të tij, si vijon:

- a) pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, për vitin 2019;
- b) raporti për zbatimin e buxhetit vjetor 2019, në nivelin e fondeve të miratuara dhe objektivat e realizuar;
- c) raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij, për vitin 2019;
- ç) raporti për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontigjencës, për vitin 2019;
- d) raporti për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit 2019.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Gramoz Ruçi